

**Nisin punimet për “Gurin e Përmetit”. Kumbaro: “ Qarku i Gjirokastrës do të kthehet në kryeqendër të turizmit. Biznesi të zgjohet dhe të ecë paralelisht me investimet e qeverisë”**

2017-04-18 13:30:00



“Muaj më parë, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Kryebashkiakun e Përmetit morëm një vendim të përbashkët që “Guri I Përmetit”, ky monument I rëndësishëm të rijetëzohet. Kështu mori jetë një projekt i përbashkët midis Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Përmetit për të kryer restaurimin , por dakordësuaam edhe për një projekt të veçantë si ndriçimi skenografik, që do ta kthejë “Gurin’ në një far të qytetit”- u shpreh nga Përmeti, Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro.

*Muaj më parë, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Kryebashkiakun e Përmetit morëm një vendim të përbashkët që "Guri i Përmetit", ky monument i rëndësishëm të rijetëzohet. Kështu mori jetë një projekt i përbashkët midis Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Përmetit për të kryer restaurimin, por dakordësuam edhe për një projekt të veçantë si ndriçimi skenografik, që do ta kthejë "Gurin" në një far të qytetit"- u shpreh nga Përmeti, Ministrija e Kulturës, Mirela Kumbaro.*

Ditën e premte në qytetin e Përmetit nisi punën kantieri më i ri i ndërtimit në trashëgiminë kulturore, "Guri i Përmetit", projekt i Ministrisë së Kulturës, Institutit të Monumeneteve dhe Bashkisë së Përmetit.

Ministrja Kumbaro ndoqi nga afër fillimin e punimeve, shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë së Përmetit, Niko Shupuli.

"Guri i qytetit të Përmetit" ndodhet në veri të zonës qendrore të qytetit, është i vendosur në një hapësirë të gjelbër prej 4500 m<sup>2</sup>.

Projekti konsiston në rijetëzimin e monumentit të kulturës nëpërmjet rikualifikimit të zonës, rivitalizimit të 'Gurit' dhe kthimit të kësaj zone në pikë interesi.

*"Besoj se është një nga projektet e suksesshme të përbashkëta me Bashkinë e Përmetit, siç janë të gjitha projektet e tjera të kantierit Rilindja Urbane. Nuk mund të jetë më Përmeti një destinacion i anashkaluar dhe ca më keq i harruar, siç ka qenë deri më sot nga harta jo vetëm e qarkut të Gjirokastrës, por edhe më gjerë, sepse Përmeti ka një pasuri të jashtëzakonshme të pasurive natyrore, kulturore, shpirtërore, që është meritë vetëm e përmetarëve dhe paraardhësve të tyre"-u shpreh Ministrija Kumbaro në vazhdim të fjalës së saj.*

Idea kryesore e këtij projekti është krijimi i një traseje përgjatë së cilës do të ketë shkëmbim informacioni kulturor e artistik. Projekti bazohet në krijimin e tri hapësirave kryesore: Tuneli, shkallët, rrënoja dhe në evidentimin e vlerave të tyre nëpërmjet ndriçimit dekorativ dhe funksional. Ky projekt është njëri nga kantieret e hapura të Rilindjes Urbane, që ka për qëllim të përmirësojë infrastrukturën, të rrisë cilësinë e shërbimeve dhe të krijojë formula të reja të turizmit, falë pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë qytetet me trashëgimi kulturore.

Kumbaro nuk harroi të kujtojë nga Përmeti se "Filozofia e qeverisë shqiptare për qarkun e Gjirokastrës është që të jetë kryeqendër e turizmit. Të kthehet në një qark me shumë pole atraktive. Krahas kantierëve të rilindjes urbane të forcojmë turizmin. Biznesi duhet të zgjohet dhe të ecë paralelisht me investimet e autoriteteve shtetërore për t'u ofruar një menu turistike të denjë çdo vizitori në këtë zonë".

Projekti "Guri i Përmetit" kap vlerën e investimit prej 8.560.848 lek dhe pritet të përfundojë në harkun kohor të dy muajve.